



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KOLEGJIN E KIRURGËVE TË KOSOVËS

1. Miratohet Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, shuma e mjeteve të ndara është në vlerë prej 4,500.00 € (katër mijë e pesëqind euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.
3. Qëllimi i këtij vendimi, është ndarja e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës, për organizimin dhe mbajtjen e Kongresit të tretë klinik të KKK-së, i cili është një organizim shkencor dhe edukativ për t'u ofruar pjesëmarrësve një gamë të gjerë të mundësive edukative, aktivitete dhe përvoja që përputhen me nevojat e tyre arsimore dhe të zhvillimit profesional, i cili do të mbahet më 12 - 15 tetor 2023.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi, është Kërkesa nr. 14-691/10-194234/23, dt. 20.09.2023 e parashtruar nga Kolegji i Kirurgëve të Kosovës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtorja e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-215685/23, më 03.11.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci

